# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443237**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Braçe i ashpër me KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Në thesarin nuk fut dot dorën kushdo, s'i vë dot kush shkelmin parave të shqiptarëve |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/politika/brace-i-ashper-me-klgj-dhe-klp-per-vendimet-per-pagat-ne-thesarin-nuk-f-i586037` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | redirected |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 13:31:11 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 14:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `abfdbbb7aa251f36c7d2f0208c15ccde076e4bae6a98f4da1a06d134ca4f69df` |
| TEKSTI | `c4bfab3f761d9e3e7ba1242783bae680faac39c204541c557b572b3ec6f7410c` |
| PAMJA | `fd4af381734156aa1385bca121b71f9594424d417dbe0305b05079e5e5651c0b` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6cf8e1b687aee6699726bf5015cb447bdefe203c25b1bb6fcb0b483d8b6db7d6` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `6e410cf6c3be6bd40f75161c1288a8066fcd1b6e7ab80a3c789507dd842f2954` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6cf8e1b687aee6699726bf5015cb447bdefe203c25b1bb6fcb0b483d8b6db7d6`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# Braçe i ashpër me KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat: Në thesarin nuk fut dot dorën kushdo, s'i vë dot kush shkelmin parave të shqiptarëve

TemA
14 Shtator 2026, 16:00Politika TEMA



Deputeti i PS-së, Erion Braçe, vijoi me kritikat ndaj KLGJ dhe KLP për vendimet për pagat e magjistratëve. Në Komisionin e Ekonomisë dhe Financave, Braçe tha se askush që nuk është i autorizuar me ligj nuk mund të vendosë për paratë e Thesarit të Shtetit.

"Në qoftë se gjithkush në këtë vend, që ka një fuqi në dorë, do të dalë nesër e të thotë "i dua të ardhurat e mia" kaq, kjo i vë shkelmin parave të shqiptarë. Ata janë paratë e taksapaguave shqiptarë. Përgjegjshmëria duhet të vijë nga këtu dhe jo nga fuqia për të detyruar. Nëse ndjek rrugën e fuqisë, natyrisht që i vëmë shkelmin shteti.

Ka qenë vullneti ynë politik, që ata të paguheshin edhe shumë më mirë se deputetët e Kuvendit të Shqipërisë. Në hierarkinë e pagave janë shumë më lart. Në thesarin e shtetit nuk fut dorën kurrkush që nuk është ia autorizuar nga ligji.

Kemi kohë që nuk kemi rënë në kriza të forta pikërisht prej kësaj, sepse nuk ka më fut dorën dhe ik. Disiplina fiskale është themelore për shtetin. A mban më ky vend të hyjë në një krizë ekonomike dhe financiare? Unë mendoj që nuk mban. Duke ruajtur se kush pozicionin e vet, mendoj se ai dalim", tha Braçe.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Plarent Ndreca: Nuk ka arsye që Veliaj të mbahet në paraburgim, gjykatat e tre shkallëve nuk treguan kujdesin e duhur

15:20 Politika

Debati i pagave të magjistratëve, analisti: Kërkesa e gjyqtarëve e tepruar, reforma në drejtësi duhet riparë

14:50 Politika / 1 koment

VIDEO/ Kriza e pagave në drejtësi, Braçe: KLGJ dhe KLP duhet t'u kërkojnë ndjesë deputetëve, morën kompetencat e Kuvendit

14:07 Politika / 5 komente

Tabaku: Mungesa e transparencës dhe konkurrencës po dëmton rrugën e Shqipërisë drejt BE-së (VIDEO)

13:38 Politika / 7 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.